

VENDIM
Nr. 120, Datë 21.7.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “REKA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: “ZAJE”, ME FUQI TË INSTALUAR 220 kw; “TURAJ”, ME FUQI TË INSTALUAR 320 kw; “XHAFERAJ-MESHTEKEN”, ME FUQI TË INSTALUAR 3680 kw; “NOVOSEJ”, ME FUQI TË INSTALUAR 220 kw DHE “KOLLOVOZ”, ME FUQI TË INSTALUAR 1500 kw, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5940 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.7.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Reka Energy sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Reka Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Reka Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Zaje”, me fuqi 220 kw; “Turaj”, me fuqi 320 kw; “Xhaferaj-Meshteken”, me fuqi 3680 kw; “Novosej”, me fuqi 220 kw; “Kollovoz”, me fuqi 1500 kw, me fuqi totale të instaluar 5940 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti